



THE STATE OF THE UNION

The State of the Union 2016: Gratë në Evropë dhe në Botë

Fjalim i hapjes i Prof. Ruth Rubio Marín, Instituti Universitar Evropian
Palazzo Vecchio, Firenze, 6 maj 2016.¹

Gentili ospiti, colleghi, autorità e amici, eccellentissime Madri, comprese quelle che non sono qui e che sono lo stesso da ringraziare per tutti coloro che sono qui, compresi i padri che hanno fatto anche loro quello che di solito fanno le madri, e compresa la mia stessa madre che si trova qui tra di noi accanto ai miei figli Simón e Lucas. É per me un vero onore essere in questo Salone dei Cinquecento che accoglieva il Gran Consiglio della Repubblica Fiorentina, con i suoi 500 membri, tutti maschi!! ad essere una delle tante voci di donne e uomini che nella giornata di oggi parleranno sulle stato delle donne in Europa e nel resto del mondo.

Të nderuar të ftuar, kolegë, zyrtarë të nderuar dhe miq, Shkëlqesitë Nëna, duke përfshirë edhe ato që nuk janë të pranishme por që duhen falenderuar për praninë tonë këtu, duke përfshirë dhe etërit tanë, ata që kanë bërë gjëra që zakonisht i bëjnë nënat, duke përfshirë edhe nënën time që është me ne në këtë sallë këtë mëngjes pranë fëmijëve e mi Simon dhe Lucas. Është një nder i madh për mua të jem këtu, në "Salone dei Cinquecento", Sallën e 1500-ës, njëherë e një kohë sallë e mbledhjeve të Këshillit të Madh të Republikës së Firences, 500 anëtarët e të cilit ishin të gjithë burra! Është një nder që të jem në mesin e shumë zërave të grave dhe burrave që do të flasin sot për gjendjen e grave në Evropë dhe në pjesën tjetër të botës.

I. Hyrje

Zonja dhe zotërinj, Evropa është duke u përpjekur, dhe është vërtetë e angazhuar në një përpjekje edhe më të thellë se në çdo kohë tjetër që nga themelimi i Bashkimit Evropian gjashtë dekada më parë, si një projekt njerëzor i dimensioneve ekonomike, politike dhe sociale. Evropa po përjeton një krizë ekonomike të tejzgjatur me pasoja të rënda sociale. Evropa po përballë me një kërcënim në rritje të terrorizmit, si edhe të populizmit, nacionalizmit ksenofob, dhe fundamentalizmit fetar të besimeve të ndryshëm. Rreziku i Grexit nuk është është larguar tërësisht, ashtu si edhe ai i Brexit po afrohet gjithnjë e më pranë, duke pasqyruar rritjen e zhgënjimit të shumë vetave me projektin evropian. Mijëra refugjatë po mbyten në detrat tonë, ndërsa mijëra të tjerë - mbi një milion - janë duke thirrur para dyerve tona dhe po u mohohet përgjigja njerëzore dhe dinjitoze që ne e dimë që e meritojnë, në fakt, si një të drejtë. Dhe e dimë shumë mire këtë, sepse shumë prej paraardhësve tanë trokitën në dyer të ngjashme kur edhe ata u përballën me tmerret e persekutimit, luftës dhe forca të tjera që kërcënonin jetën, ose sepse jo shumë kohë më parë dhe

¹ Ky tekst është përkthim i variantit të shkruar të "Gjendjes së Bashkimit" të Institutit Universitar Evropian, i prezantuar në Palazzo Vecchio, Firenze, Itali, 6 Maj 2016. Përkthimi në gjuhën shqipe është bërë nga Adea Pirdeni. Për citimet dhe tekstin e plotë me shënimet bibliografike ju lutem referohuni variantit në anglisht të Ruth Rubio-Marín, "Women in Europe and in the World: The State of the Union 2016", 14 I.CON (2016).

për shumë të tjerë, vetë ne ishim pjesë e këtyre forcave kërcënuese. Disa nga ju mund të ketë pyetur veten: Në këtë kontekst, cili është qëllimi i një "Gjendje të Bashkimit" që u përkushtohet grave?

E pra, atëherë më lejoni t'ju pyes unë ju: kur do të jetë koha e duhur për të shtruar pyetjen "Grua"? Nëse kthehemi pas në histori, afërsisht një shekull më parë, kur përpjekjet për të drejtën e grave për të drejtën e votës zhvilloheshin në vende të ndryshëm në Evropë, do të gjejmë shumë shembuj se si grave iu kërkua të zbrapseshin, me bujarinë dhe vetësakrificimin që shumë shpesh pritet prej tyre, për hir të kauzave të tjera të konsideruara "më të rëndësishme" ose "më urgjente". Të gjitha ato u përpoqën dhe luftuan në emër të lirisë dhe barazisë: lufta e klasës socialiste, levizjet nacionaliste, luftërat, ose përpjekjet për të kufizuar pushtetin e kishës dhe monarkisë si rudimente të regjimit të vjetër. Por ajo që ne pranojmë sot, dhe që ka qenë e mohuar në atë kohë, është që përfshirja e grave në "demokracitë e reja" ishte gjithashtu një çështje barazie dhe lirie. Pra, sërish, unë do të pretendoj sot se kredencialet demokratike të Evropës dhe zotimi për drejtësi shoqërore vihen në provë në këtë moment thelbësor, dhe një pjesë e madhe e asaj që do të përcaktojë suksesin ose dështimin e saj është pikërisht se si Evropa i përgjigjet pyetjes "Grua".

Por, më ekzaktesisht, ju po i shtroni vetes pyetjen çfarë është çështja "Grua" sot? Pikërisht sot që gratë gëzojnë të njëjtat të drejta dhe liri si burrat, tani që më në fund kemi fshirë nga sistemet tonë ligjorë ato gjurmët e turpshme të patriarkalizmit që për vite të tërë i kanë barazuar gratë me të miturit? Në fakt, realiteti fatkeq është se sot, pavarësisht statusit ligjor të barazisë formale, gratë në Evropë, që përbëjnë më shumë se gjysmën e popullsisë, mbeten një grup social i shtypur. Si mund të kuptohet kjo situatë? Filozofja Iris Young, përpara vdekjes së saj të parakohshme, shpjegonte në shkrimet e saj se shtypja konsiston në çdo sistem që redukton potencialin e njerëzve për të qenë tërësisht njerëzorë, ose sepse ato trajtohen në një mënyrë çnjerëzore, ose sepse atyre u mohohen mundësitë që do t'u lejonin që të përmbushnin potencialin e tyre njerëzor, fizikisht dhe mendërisht. Mbani parasysh se shtypja nuk ndodh vetëm në rastet e ekzistencës së një tirani mizor me qëllime të këqia. Në fakt, një shoqëri liberale me qëllime të mira mund të vendosë kufizime sistematike mbi grupe dhe të kufizojë lirinë e tyre, duke u bazuar jo vetëm në norma të dukshme por edhe në norma që nuk vihen fare në diskutim, zakone, dhe simbole. Sipas Young, shtypja ka pesë fytyra, konkretisht: dhunën, shfrytëzimin, marginalizimin, mungesën e pushtetit, dhe imperializmin kulturor.

Zonja dhe zotërinj, ne duhet të përgëzojme vetveten, paçka se në një mënyrë paksa paradoksale, pasi më në fund ne kemi prova empirike që vërtetojnë se gratë në Evropë, disa gra më shumë se të tjerat, përballen me këto pesë fytyrat e shtypjes si pjesë e ekzistencës sonë të zakonshme. Këto të dhëna janë mbledhur nga studime shumë rigorozë dhe nga mekanizma që janë zhvilluar këto vitet e fundit, përfshirë dhe anketimin në mbarë BE-në për dhunën ndaj grave nga Agjencia për të Drejtat e Njeriut në BE në 2014. Ky raport u bazua në intervistat me 42 mijë gra në 28 shtetet anëtare të BE. Gjithashtu, kemi në dispozicion një raport të shkëlqyer për barazinë midis grave dhe burrave të të njëjtit vit të publikuar nga Komisioni Evropian dhe raportet e Indeksit të Barazisë Gjinore të Institutit Evropian për Barazi Gjinore, të cilët kanë matur në mënyrë rigorozë barazinë gjinore në BE dhe evolucionin e saj që nga 2005 deri në 2012, duke evidentuar boshllëqe të natyrës gjinore në disa fusha të lidhura me kuadrin politik të BE, duke përfshirë, punën, paranë, dijet, kohën, pushtetin, shëndetin, dhunën dhe pabarazitë e kryqëzuara.

Duke marrë shkas nga sa më sipër, do të shpjegoj tani se përse dhe si gratë në Evropë vazhdojnë të jenë të shtypura, duke piketuar dhe skenare të mundshëm për të ardhmen. Do të përball implikimet e këtyre skenareve të mundshëm për vetëkuptimin e Evropës si një hapësirë gjeopolitike që i përkushtohet vlerave demokratike dhe ideve të drejtësisë shoqërore: Unë gjykoj se ky zotim, duhet të jetë pjesë thelbësore e *raison d'être* të BE-së.

Më lejoni, atëherë, të adresoj tani se çfarë na tregojnë të dhënat. Nga ç'këndvështrim mund t'i gjejmë këto pesë format e e shtypjes së grave në Evropë?

II. Fytyrat e shtypjes

E para, dhe më e keqja: dhuna

Kohët e fundit i është kushtuar shumë vëmendje nga opinioni publik dhunës ndaj grave migrante, këndvështrimit perëndimor për "atë gruan tjetër", duke përfshirë gratë viktime të trafikimit kryesisht për qëllime të shfrytëzimit seksual, dhe vajza që i nënshtrohen mutilimit gjenital. Por, me të drejtë, raporti i Agjencisë për të Drejtat Themelore në BE vendosi të flasë për ne dhe jo për ato. Dhe ajo çfarë dimë për veten tonë është pikërisht ajo çfarë BE është sot, 1 në 3 gra ka përjetuar dhunë fizike dhe/ose psikologjike të paktën një herë që nga moshë 15 vjeçare, që në tërësi përbën 59.4 milion viktime, me një përqindje të ngjashme për vajzat nën këtë moshë. Ajo çfarë dimë gjithashtu është se 1 në 20, ose një grup prej afërsisht 9 milion grash, janë përdhuruar së paku një herë që nga moshë 15 vjeçare, një përvojë e cila lë pas të mbijetuar me frikë, zemërim, turp, ankth dhe humbje të vetëbesimit. Ajo çfarë ne dimë është se ndërmjet 45 dhe 55%!! e grave në Evropë kanë përjetuar ngacmime seksuale dhe 18 % e tyre kanë përjetuar forma të ndryshme të përndjekjes, duke veçuar përndjekjen virtuale të shndërruar në një tendencë veçanërisht midis të rinjve. E megjithatë, dyshoj se këto shifra përfshijnë të gjitha format e dhunës që kanë ndikim negativ tek gratë veçanërisht vulnerabël, duke përfshirë dhe gratë migrante (statusi i migracionit të të cilave shpesh i vendos ato në situata të varësisë ekstreme ndaj bashkëshortëve ose punëdhënësve të tyre, ose të të dyve), azilkërkuueset dhe refugjatët (të cilët, në momentin që flasim, janë viktime të trafikimit dhe po abuzohen seksualisht nga zyrtarët, migrantët e paligjshëm dhe nga refugjatët e tjerë në zona traziti dhe qendra pritje), ose gra me aftësi ndryshe (të cilat në përgjithësi shpesh jetojnë në periferi të shoqërisë dhe rendit juridik).

Ajo çfarë është veçanërisht e dhimbshme, zonja dhe zotërinj, është fakti që, për çdo 1 në 5 gra, përvoja e dhunës fizike ose psikologjike shkaktohet ose nga partneri ekzistues ose nga partnerë të mëparshëm. Në të njëjtën kohë, i frikshëm, shumë i frikshëm, është fakti se vetëm 14 % e grave raportojnë në polici incidentet më serioze me partnerët intimë.

Tani, zonja dhe zotërinj, quheni si të doni, por për mua kjo nënkupton se miliona gra evropiane jetojnë në një gjendje terrori dhe shtypje, shpesh brenda shtëpive, shkollave, lagjeve dhe vendeve të punës së tyre.

Shfrytëzimi dhe marginalizimi

Disa fjalë tani për shfrytëzimin dhe marginalizimin, fytyra e dytë dhe e tretë e shtypjes. Aktualisht, përqindja e grave të punësuar është ende 63,5 % dhe për çdo një euro që paguhet një burrë, një grua në të njëjtin vend pune dhe me të njëjtin nivel arsimor paguhet vetëm 84%. Hendeku gjinor në pagë vazhdon të ruhet nga praktika e përgjithshme e mungesës së transparencës mbi pagat nga pothuaj çdo punëdhënës. Edhe më shqetësues është fakti se hendeku gjinor në pensione është 38%, ose fakti që një e treta e grave nuk përfitojnë fare pensioni i ekspozon gratë në një moshe të madhe së bashku me nënat e pamartuara ndaj rreziqeve të lartë të varfërisë dhe marginalizimit.

Segregimi më marrëdhëniet e punës përqendron gratë në sektorët më pak fitimprurës. Gratë e punësuar kanë ende katër herë më shumë mundësi të punësohen në punë me kohë të pjesshme

sesa burrat e punësuar, kryesisht duke kombinuar punë shtëpiake të papaguar dhe punësim të paguar. Në tërësi, hendeku në paga që rezulton nga pagesa më pak për orë, të punuarit më pak orë në punë të paguar, dhe mospërfaqësimi në punë të paguara shumë mirë arrin shifrën 37%. E megjithatë, çdo e dhënë zbehet përkundrejt realitetit kur bëhet fjalë për hendekun gjinor mbi resurset ekonomike dhe të dhëna të ndara sipas gjinisë mbi resurset nga asete të tjerë financiarë, si bonot ose pasuritë e paluajtshme thjesht mungojnë.

Ndërkohë, zonja dhe zotërinj, burrat e punësuar u kushtojnë vetëm 8 orë në javë punës së papaguar dhe kujdesit në shtëpi, krahasuar me 26 orë në javë për gratë e punësuar, të cilat mbajnë një barrë afërsisht tre-fish më të madhe. Në të njëjtën kohë, zonja dhe zotërinj, shumë gra emigrante gjejnë punë të nënpaguara si kujdestare për fëmijë dhe të moshuar, ose punë shtëpiake, duke punuar në të zezë. Kjo u mundëson grave që paguhet me paga të larta, të shtojnë orët e punës pa përfutur subvencione publike: një zgjidhje kjo e tregut për ofrimin e përkujdesjes që mund të duket se është efiçente në lidhje me koston e saj në afatshkurtër, por nuk është një zgjidhje e qëndrueshme në afatgjatë. Kjo u heq mundësinë vendeve me të ardhura të ulta, andej nga vijnë emigrantët, për të gjeneruar të ardhura për rritjen dhe edukimin e këtyre njerëzve, përveç remitancave vullnetare (dhe shpesh të përkohshme) individuale, ashtu siç edhe shteron resurset e përkujdesjes së vetë këtyre vendeve.

Për mua kjo përbën një shembull të asaj që Young e quan shfrytëzim, pra, përdorimi i punës së njerëzve për të prodhuar fitime por duke mos u ofruar atyre kompensim të drejtë. Gjithashtu, ajo çfarë Young identifikon me marginalizim është akti i dhënies së një pozite më të ulët një grupi njerëzish në një pozitë sociale më të ulët ose në skajet e shoqërisë, ku mamatë e pamartuara, Eccellentissime Madri, gjithnjë e më shumë e gjejnë veten në këtë pozitë si në Evropë dhe gjetkë.

Mungesa e pushtetit

Mungesa e pushtetit është fytyra e katërt e shtypjes.

Pavarësisht se përfaqësojnë pothuajse gjysmën e fuqisë punëtore të punësuar, gratë përbëjnë ende më pak se një të katërtën e anëtarëve të këshillave drejtues të shoqërive të mëdha të kompanive të listuara në bursë në vendet anëtare të BE. Që nga nëntori i vitit 2014, ato përbëjnë ende vetëm mesatarisht 28% të anëtarëve të zgjedhur të parlamenteve të vendeve anëtare dhe të qeverive të vendeve anëtare.

Në nivelin e institucioneve të BE-së ka pasur progres edhe pse jemi ende larg nga barazia. Përqindja e grave në Parlamentin Evropian tani është në nivelin më të lartë që ka qënë ndonjëherë me 37%, por ende 13 % larg barazimit. Komisioni i ri përbëhet nga 19 burra dhe vetëm 9 gra; vetëm 21 % e gjyqtarëve në Gjykatën e Drejtësisë janë gra; dhe Këshilli Drejtues i Bankës Qendrore Evropiane përbëhet ende nga 22 burra dhe vetëm 2 gra.

Eshtë e panevojshme të përmendet këtu se numri i grave që kanë thyer tavanin e qelqit dhe qendrojnë në domenin e pushtetit, autoritetit dhe vendimmarrjes të burrave do të jetë edhe më i ulët nëse marrim në konsideratë gratë me të ardhura të ulta apo gratë migrante.

Imperializmi kulturor

Së fundi, imperializmi kulturor.

Në themel të padrejtësisë gjinore qëndron androcentrismi, të cilin teoricienja e shkencave politike Nancy Fraser e përkufizon si një model të institucionalizuar të vlerave kulturore që privilegjon

tipare dalluese që lidhen me gjininë mashkullore, ndërsa zhvlerëson gjithçka të koduar si femërore. Modelet me vlera androcentrike janë të kodifikuara shprehimisht në shumë sfera të së drejtës, politikave qeveritare, por edhe në kulturën popullore, përdorimin e gjuhës dhe në bashkëveprimin e përditshëm, duke përfshirë dhe tregun. Apo është thjesht rastësore që, stereotipikisht, punët e grave (përveç se janë më pak të paguara) ka gjasa të lidhen me përkujdesjen dhe me sigurimin e shërbimeve, punë që kërkojnë punë shumë intensive dhe me potencial të kufizuar për rritje produktiviteti? Fakti është, zonja dhe zotërinj, që vlera shoqërore e punës së përkujdesjes, absolutisht thelbësore për të mbështetur ekonominë dhe shoqërinë e tregut, Eccellentissime Madri, thjesht nuk i njihet vlera e duhur. Prej një kohe të gjatë ekziston një dualizëm hierarkik midis punës prodhuese dhe riprodhuese, dhe siç ka argumentuar dhe fituesi i çmimit Nobel Joseph Stiglitz, ka një mungesë totale të çdo marrëdhënie ndërmjet shpërblimeve private dhe avantazheve sociale. Normat shoqërore dhe nocionet jo të qartë të produktivitetit marginal janë përcaktues për pagat. Mendoni për shembullin e ofruar nga Perrons dhe Plomien, për një drejtues të një banke të falimentuar në Mbretërinë e Bashkuar, i cili kishte këshilluar për ristrukturimin e një pagë mujore ekuivalente me tre herë e gjysëm paga vjetore e një kujdestari për fëmijë me njëzet vjetë përvojë pune.

Megjithatë, androcentrismi nuk është e vetmja formë e imperializmit kulturor që i nënshtrohen gratë në Evropë. Heteronormativizmi si dhe format e imperializmit fetar dhe etnik janë përcaktues për jetën e grave në Evropë: pyesni një grua lezbike që kërkon të shprehë plotësisht emocionet dhe dëshirat e saj familjare; pyesni një grua rome që kërkon respekt për autonominë e saj seksuale dhe riprodhuese; pyesni një grua transgjimore që kërkon njohje ligjore; apo një grua myslimane që dëshiron të mbajë shami kur shkon në universitet; dhe ato do t'ua tregojnë.

III. Mundësitë e zgjidhjes për të ardhmen: Evropa në një moment tepër të rëndësishëm

Atëherë, çfarë ka bërë Evropa dhe çfarë po bën Bashkimi Evropian për këtë? Evropa, zonja dhe zotërinj, është në një moment tepër të rëndësishëm. Më lejoni të shpjegoj pse:

Që pre fillimeve të veta BE-ja ka mbështetur në mënyrë të vazhdueshme rritjen ekonomike dhe kohezionin social, dhe ky shqetësim për pabarazitë socio-ekonomike dhe qëllimi final për të përmirësuar jetën e njerëzve ka evoluar nga Traktati i Romës, përmes Strategjisë së Lisbonës me shtyllat e saj ekonomike, sociale dhe mjedisore, dhe deri në agjendën aktuale Evropa 2020 për rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Kërkimi për të arritur barazi gjinore, duke filluar që me pagën e barabarë në Traktatin e Romës, ndjekur nga direktivat e shumta dhe politikat inovative, kanë ndikuar fuqimisht këtë avancim, është parë si element kyç për zbatimin e suksesshëm të agjendës ekonomike dhe rritjes. Qëllimi i përgjithshëm ka qënë t'u sigurojë grave mundësi të barabarta në fushat e punësimit dhe shërbimeve, dhe në të njëjtën kohë mbrojtjen e tyre nga praktikat diskriminuese si nëna, në mënyrë të tillë që të ruhet angazhimi tradicional i Evropës, që nga fillimet e shtetit social, për mbrojtjen e familjes dhe mëmësisë.

Në veçanti që nga mesi i viteve 1990 e në vijim, në bazë të Strategjisë Evropiane të Punësimit të BE-së, që u formulua në një kontekst ku është supozuar se nuk do të ketë kufizime të përgjithshme mbi mundësitë e punësimit, nxitja e punësimit të grave dhe barazisë gjinore të grave ka fituar një legjitimitet të ri. Kjo i shtyu të gjithë shtetet anëtare të BE-së që të përmirësojnë sistemet e prindërimit, të rrisin shërbimet e përkujdesjes ndaj fëmijeve me qëllim arritjen e objektivit të rritjes së përqindjes së punësimit të nënave. Për më tepër, përtej konsideratave ekonomike, si Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës kanë filluar të vlerësojnë objektivin

ambicioz të fuqizimit të grave si një kriter themelor të demokracisë duke i bërë jehonë shqetësimeve të shprehur në nivel global në Konferencën e Pekinit dhe Platformës për Veprim. Në disa shtete, ky qëllim u bë ai i demokracisë së partietit, një koncept i lindur në Evropë.

Por fatkeqësisht, analiza e dokumenteve të fundit të politikave të BE-së në lidhje me qëllimet, instrumentet dhe mjedisin e politikëbërjes tregon se vëmendja për çështjet gjinore është bërë shumë më pak e rëndësishme dhe e përshtatshme se në dekadat paraardhëse. Kjo rënie në ndjesinë e urgjencës në politikat evropiane është e lidhur qartë me shpërthimin e krizës financiare dhe ekonomike dhe masat shtrënguese që e pasuan atë. Për fat të keq, perceptimi se kriza ekonomike ishte në radhë të parë një krizë për burrat do të thotë që konsideratat e barazisë gjinore kanë munguar në hartimin e politikave gjatë krizës. Pjesa më e madhe e vendeve kanë dëshmuar një tkurrje në angazhimet për barazi gjinore, ose përmes ndalimit të makinerisë së politikave të barazisë gjinore, ose nëpërmjet pakësimit të konsiderueshëm të veprimtarisë së kësaj makinerie. Mesazhi i nënkuptuar që duket se përçohet është se politika të tilla në rastin më të mirë janë një shpërqendrim nga kriza aktuale. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se arritjet e këtyre pak viteteve të fundit kanë qënë zero. Ka pasur vërtetë disa gurë kilometrikë të rëndësishëm veçanërisht në luftën kundër dhunës, të tillë si miratimi në 2011 i Konventës së Stambollit për të parandaluar dhe luftuar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje. Gjithashtu, në nivel të BE-së ne duhet të festojmë miratimin e Direktivës mbi Parandalimin dhe Luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore (2011) dhe Direktivën e Viktimave (2012). Por, me përjashtim të Marrëveshjes Kuadër për zgjatjen e periudhës së lejes prindërore nga tre deri në katër muaj, të gjitha iniciativat e tjera legjislative për të avancuar më tej në drejtim të fuqizimit të grave dhe trazimin e roleve gjinore kanë dështuar, duke përfshirë reformat e propozuara për lejen e lindjes dhe Direktivën për Kohën e Punës, si edhe për balancën gjinore në Direktivën e Këshillave Drejtues të Korporatave.

Pra, krizë, krizë, masa shtrënguese dhe më shumë krizë! Por si rezultuan gratë dhe hendeku gjinor në krizë dhe nën masa shtrënguese? Dhe çfarë na tregojnë këto fakte për të ardhmen e grave në Evropë? Bazuar në punën e Karamessini dhe Rubery's, ne kemi mësuar në thelb tri gjëra.

1. Së pari, pavarësisht nga rënia e konsiderueshme e punësimit si për burrat dhe gratë me shpërthimin e krizës, pjesëmarrja e grave në tregun e punës ka rezultuar në fakt me rritje gjatë këtyre viteve, bazuar në të ashtuquajturin efektin e punëmarrësit të shtuar. Duke mos e lënë tregun e punës, gratë që humbën punët vazhduan të kërkonin punë, shumë u shndërruan në të vetmin preson që mban familjen dhe disa u futën në tregun e punës për herë të parë. Një rikthim në modelin e familjes ku burri është personi që mban familjen duket e pamundur në ekonominë e zhvilluar. Kjo do të kërkojë riformatimin e strukturave tradicionale të familjes, të themeluar mbi bazën e lidhjeve të forta familjare, punësim të sigurt për burrat dhe punë me paga familjare të mjaftueshme, asnjëra prej të cilave nuk duket të jetë e mundur. Në fakt, duke pasur parasysh plakjen e popullsisë, ka një interes të përgjithshëm për të mbajtur si gratë dhe burrat në tregun e punës sa më gjatë.
2. Së dyti, pabarazitë gjinore në punësim janë zvogëluar disi. Megjithatë, kjo është pasojë e humbjes së madhe të vendeve të punës dhe përhapjes së formave me kohë të pjesshme dhe më fleksibël të punësimit midis burrave, si edhe ngrirjet e pagës, shkurtimet e pagave dhe përkeqësimin e përgjithshëm të kushteve të punës, gjë e cila i ka prekur të gjithë. Pra, me fjalë të tjera, ka qënë një proces i sheshimit të standardeve që ka mbyllur disi hendekun gjinor.
3. Së fundi, bazuar në masat shtrënguese dhe politikat e konsolidimit fiskal, ka pasur një tkurrje të sektorit publik, një punëdhënës i madh për gratë - pjesërisht sepse u mundëson atyre që të jenë të punësuar dhe nëna-, ashtu si edhe një lloj tërheqje të përgjithshme të shtetit nga

riprodhimi shoqëror, gjë e cila është shfaqur përmes shkurtimeve të mbështetjeve për prindërit që punojnë dhe për kujdesin afatgjatë të të moshuarëve dhe të personave me aftësi ndryshe. Siç pohon ekonomistja feministe Nancy Folbre, ky evolucion nënkupton se pabarazia gjinore në vetvete po bëhet më pak kritike se sa tendencat që janë etiketuar si "varfërimi i mëmësisë" dhe "mëmësimi i i varfërisë", të cilat, në fakt, kanë një ndikim negativ mbi gratë.

Pra, ja ku jemi. Duke avancuar përpara, këto tendenca duket se tregojnë dy skenarë të mundshëm. Unë do të mbështes idenë se vetëm njëri prej tyre është i përputhshëm me vetëkuptimin original të Evropës për t'iu përkushtuar barazisë gjinore, demokracisë, dhe drejtësisë shoqërore.

Sipas skenarit të parë, do të vazhdojnë të ekzistojnë tendencat aktuale drejt intensifikimit të neo-liberalizmit, si dhe supozimet se ekonomia dhe politikat ekonomike krijojnë mirëqënie dhe janë produktive, ndërsa politikat sociale janë joproduktive, si dhe përbëjnë një kosto dhe frenojnë rritjen. Sipas mendimit të shumë vetave, mbi bazën e këtij skenari mund të parashikojmë një lëvizje drejt shoqërive më të polarizuara sipas klasës dhe përkatësisë etnike. Ne mund të presim një barazim të kushteve financiare dhe të punësimit midis burrave dhe grave me arsimim/aftësi të nivelit të ulët dhe të emigrantëve, si dhe zgjerimin e hendekut gjinor të situatës dhe të parashikimeve për burrat dhe gratë me arsimim/aftësi të nivelit të lartë. Ky është tashmë realiteti në SHBA. Kjo situatë do të shpjerë në rritjen e pabarazisë midis dy grupeve dhe uljen e përgjithshme të pozitës dhe pritshmërive të punësimit të grave dhe burrave. Në të njëjtën kohë, moszhvillimi i mbështetjes shtetërore për përkujdesjen, ose zvogëlimi i parashikimeve ekzistuese lidhur me të, mund të passjellë reagime të ndryshme në varësi të klasës dhe gjinisë. Gratë me arsimim të nivelit të ulët do të rrisin kohën e shpenzuar në punë të papaguara, ose do të rrisin përfshirjen në punë me kohë të pjesshme; Gratë me arsimim të nivelit të lartë mund të duhet të mbështeten më shumë në përkujdesjen e paguar në shtëpi, ose në një ndarje më të barabartë të përkujdesjes së papaguar me partnerin e tyre. Pra, mbi bazën e këtij skenari, ata që janë më shumë në nevojë për përkujdesje, gratë nga klasat e ulëta sociale, gratë migrante, gratë e reja dhe prindërit e vetëm, do të jenë humbësit më të mundshëm. Lindshmëria do të mbetet e ulët, dhe ideologjitë konservatore gjinore dhe të familjes mund të përhapen gjithsesi pjesërisht si një lloj reagimi, në veçanti por jo vetëm, në disa nga shtetet më të rinj anëtarë të BE, gjë e cila ndoshta mund të shkaktojë përçarje të mëtejshme brenda BE-së.

Në një skenar tjetër, siç edhe shumë e kanë mbështetur, kriza bashkëkohore globale ekonomike do të perceptohet si një mundësi për të ndryshuar modelin mbizotërues neo-liberal të kapitalizmit. Mund të artikulohet një thirrje për një model më gjithëpërfshirës të zhvillimit, i cili, ndryshe nga pozita tradicionale e majtë, tani integron edhe perspektivën gjinore, dhe merr në konsideratë dhe vlerën e aktiviteteve jashtë tregut, duke përfshirë përkujdesjen. Ky kuadër i ri emancipues do të duhet të vazhdojë të sfidojë stereotipet gjinore dhe rolet e paracaktuara gjinore, si edhe të integrojë shqetësimet ekonomike, mjedisore dhe të riprodhimit shoqëror. Përfaqësimi i barabartë i grave në çdo aspekt të vendimmarrjes, që përbën demokracinë e paritetit, do të jetë pjesë e kësaj panorame. Por, përtej pranisë së barabartë të grave kjo axhendë do të kërkojë zbatimin e qasjeve inovative të politikave dhe mekanizmave të barazisë gjinore, të tilla si integrimi gjinor në politikat makro-ekonomike dhe buxhetimi gjinor. Politikat e balancimit midis punës dhe jetës duhet të synohen të tilla që të jenë në thelb të mira për të gjithë, dhe jo vetëm për gratë. Kjo do të kishte si objektiv përkujdesje të përbalueshme dhe cilësore për fëmijët, përkujdesje pas shkollës, dhe përkujdesje për persona në ngarkim (duke përfshirë të moshuarit dhe personat me aftësi ndryshe). Kjo do të kërkonte leje të paguar të barabartë dhe të patransferueshme për gratë dhe burrat. Kjo do të kërkonte marrëveshje fleksibile të punës, të tilla si ndarja e punës me dikë tjetër,

puna nga shtëpia, kohë pune fleksibël dhe masa inovative për të nxitur ndarjen e barabartë të punës dhe përkujdesjes (duke përfshirë edhe stimujt përmes taksave).

Për të përfunduar, vetëm përmes këtij skenari të dytë mund të aspirojmë që të ngushtojmë hendeqet gjinorë që sot dëshmojnë pesë fytyrat e shtypjes të grave evropiane, dhe mund të kapërcejmë ngurtësinë e idelogjisë gjinore që ka lënduar kaq shumë gra dhe kaq shumë burra gjithashtu, në kaq shumë mënyra, dhe për një kohë kaq të gjatë. Gjithashtu, vetëm mbi bazën e këtij skenari të dytë mund të shpresojmë që të parandalojmë përkeqësimin e përgjithshëm të kushteve të klasave të mesme dhe të ulëta, dhe të frikës, pasigurisë, dhe ndjesisë së mospasjes, që rezulton prej tij, duke i goditur veçanërisht fort të rinjtë (zonja dhe zotërinj, një brez i tërë i humbur?!?). Frika, pasiguritë dhe ndjesia e mospasjes mund të ushqejë vetëm fundamentalizëm fetar të atij lloji që shpesh vetëpërcaktohet përmes çështjeve të kontrollit të trupave të grave dhe seksualitetit të tyre. Ato mund të gjenerojnë vetëm racizëm, ksenofobi dhe populizëm, dhe bashkë me të, një ekzistencë ferri për migrantët midis nesh, migrantët e nevojshëm për të paguar pensionet tona, për të vijuar rritjen e popullsisë dhe për t'u përkujdesur për fëmijët tanë dhe të moshuarit; dhe një ekzistencë ferri për azilkërkuessit që mbyten në ujërat tona. As nuk do të inkurajojë kjo frikë, pasiguri dhe ndjesi mospasje, burrat evropianë, përfshirë të rinjtë, që të heqin dorë tërësisht nga ajo që Rousseau e quante "iluzioni i të zotit mbi skllavin", që është, dominimi mashkullor, pasi burrat mund të perceptojnë hierarkinë me bazë gjinore si bastionin e tyre të fundit të rehatit dhe ndjenjës së vetvetes në kontekstin e zhburrërimit. Kjo përkthehet në mjerim për gratë që do të vazhdojnë të jetojnë të terrorizuara në vetë shtëpitë e tyre. Dhe në qoftë se këto forca do të mbizotërojnë, zonja dhe zotërinj, Eccellentissime Madri, Evropa do të ketë humbur vërtetë jo vetëm angazhimin e saj për barazi dhe drejtësi, por edhe të gjitha kredencialet e saj demokratike.

Pra, tani, më shumë se kurdoherë më parë, është pikërisht koha për të ngritur pyetjen "Grua" dhe për të adresuar të gjitha ato çështje të tjera që janë të lidhura fort me të. Dhe ky, Salone dei Cinquecento, është pikërisht vendi për ta bërë këtë, për këtë salloni është ndërtuar në vitin 1494, pas një prej dëbimeve të familjes Medici nga Firenze, djepi i Rilindjes dhe humanizmit të saj, një lëvizje që synonte të mposhte forma të shumta të dogmatizmit mesjetar. Ashtu si edhe tani, nëse do të përballemi dhe adresojmë vërtetë çështjen "Grua", kjo mund të kërkojë zhvendosjen e dogmatizmave për tregjet e parregulluara financiare botërore, shtetet liberale që zbatojnë masa shtrënguese, vetë-mjaftueshmërinë e qenieve njerëzore. Kjo mund të kërkojë shpëtimin, ashtu siç bëri Rilindja, të burrit individual, dhe në fakt të gruas individuale gjithashtu, nga forma të ndryshme të tiranisë dhe versioneve të saj moderne.

Ju falenderoj shumë për vëmendjen tuaj.